



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2238 Prot

Lezhë, më 22 / 2 /2023

VENDIM

Nr. 14, datë 21 / 02 /2023

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË SHPËRBLIMEVE TË AKTIVITETEVE TEMATIKE
KULTURORE-ARTISTIKE DHE TURISTIKE**

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1, Neni 25, Neni 54 pika k, të Ligjit nr.10352 datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, kreu VI “Institucionet publike vendore të artit dhe të kulturës” neni 29 “Burimet e financimit të institucioneve publike vendore të artit dhe kultures” pika a b, c, ç, d, dh, si dhe të vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 120 date 02.12.2022 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2023 dhe programit buxhetor afatmesem 2023-2025”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të shpërblimeve të artistëve, moderatorëve, kulturologëve, historianëve, studiuesve, shkrimtarëve dhe poetëve, që do të marrin pjesë në realizimin e eventeve dhe veprimtarive artistike, kulturore dhe turistike te propozuara nga Këshilli Artistiko-Kulturor dhe Turistik si më poshtë:
 - a. Shpërblim maksimal 100000 - 150000 lekë për artistë me rëndësi kombëtare për aktivitetet që Bashkia Lezhe u jep një rëndësi të kësaj forme dhe për çmimet e para të konkurseve me rëndësi kombëtare.
 - b. Shpërblim mesatar 30000 - 100000 lekë për anëtarë jurie konkurses, fituesit e çmimeve, artistët në nivel kombëtar dhe lokal në konkurse letrare, artistike, kulturore.
 - c. Shpërblim minimal 5000 - 50000 lekë për moderatorë, artistë, instrumentistë, recitues, akademikë dhe studiues për aktivitete me rëndësi lokale.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Turizimit dhe Kulturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 187/13 Prot.

Lezhë, më 27.02.2023

Lënda: **Konfirmim vendimi**

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 29 të ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.14, datë 21.02.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për miratimin e nivelit të shpërblimeve të aktiviteteve tematike kulturore-artistike dhe turistike" të ndryshuar.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

